



Njoftim Shtypi Nr. 07/216
PËR SHPËRNDARJE TË MENJËHERSHME
2 Tetor 2007

Fondi Monetar Ndërkombëtar
Uashington, D.C. 20431 USA

Deklaratë në përfundim të një Misioni të FMN-së në Shqipëri

Një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) i kryesuar nga Z. Gerwin Bell vizitoi Tiranën në 19 - 25 Shtator 2007 për të diskutuar me autoritetet shqiptare zbatimin e buxhetit 2007, buxhetin e vitit 2008 dhe ndikimin fiskal, financiar, dhe makroekonomik të krizës aktuale energjitike. Misioni u takua me kryeministrin Berisha, Ministrin Bode, Ministrin Ruli, Guvernatorin Fullani, me qeveritarë të tjerë të nivelit të lartë dhe përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar dhe jep deklaratën që vijon në përfundim të misionit në 25 Shtator 2007:

“Misioni dhe qeveria kanë arritur një marrëveshje në parim për parametrat kryesorë të buxhetit të 2008 mes rreziqeve fiskale në rritje. Tronditjet e pafavorshme të shkaktuara nga faktorë të jashtëm nuk kanë ndikuar deri tani në zhvillimin ekonomik, por ato kanë çuar drejt një rritjeje të presioneve inflacioniste. Performanca e eksportit, e cila ka qënë më e fuqishme sesa ishte parashikuar, përfshirë këtu dhe turizmin, ka kompensuar pjesërisht ndikimin negativ të krizës energjitike ndërsa prodhimi industrial ka qënë i mbrojtur nga ndërprerjet e energjisë në një masë të madhe. Besueshmëria që ka krijuar tashmë Banka e Shqipërisë, duhet të ndihmojë për të mbajtur inflacionin nën kontroll.

“Buxheti i vitit 2007 është në rrugën e duhur. Pavarësisht nga një përsheptim i arritur në krahasim me vitin e kaluar, implementimi i shpenzimeve kapitale mbetet gjithësesi i ngadaltë, duke penguar kështu një zbatim efikas të buxhetit dhe duke ndërlikuar menaxhimin e likuiditeteve.

“Është arritur një marrëveshje në parim mbi objektivat e buxhetit 2008, megjithëse rreziqet janë shtuar. Misioni dhe qeveria ranë dakord për parametrat kryesorë të buxhetit të vitit 2008, duke përfshirë huamarrjen e brendshme, parashikimet e të ardhurave dhe fushat prioritare të shpenzimeve, të cilat do të mbeten shëndetësia, arsimit dhe investimet në infrastrukturë. Duke u nisur nga shtimi i rreziqeve në ekonomi, u identifikuan kontigjencat e duhura të shpenzimeve, duke përfshirë dhe rritjen e pagave dhe pensione, për të mbrojtur zbatimin e buxhetit.

“Progresi vazhdon në fushat kryesore të reformave strukturore, sikurse janë politika e të ardhurave, administrimi i të ardhurave, si dhe menaxhimi i borxhit. Misioni mirëpret hapat e planifikuar për të zgjeruar më tej bazën tatimore që, së bashku me masat e tjera kompensuese të të ardhurave, do t'i lejojë qeverisë të ulë në mënyrë të qëndrueshme nivelin e taksës mbi të ardhurat e korporatave. Kjo së bashku me përmirësimet e planifikuara në efikasitetin e regjistrimit të tatimpaguesve dhe të administrimit të sigurimeve shoqërore, do të ndihmojë në uljen e informalitetit, e cila do t'i lejojë ekonomisë të vjelë përfitimet nga zhvillimi i metëjshëm i tregut financiar në të ardhmen. Ne e mirëpresim kohëzgjatjen e ndjeshme të maturiteteve të borxhit të brendshëm të qeverisë, duke pritur thellimin e mëtejshëm të tregut të brendshëm të lekut dhe të bondeve.

“Pavarësisht nga përpjekjet e mirëpritura të ndërmarra nga drejtuesit e KESH-it, do të nevojiten masa të tjera në sektorin e energjisë elektrike. Janë realizuar objektivat për arkëtimet dhe humbjet sipas Plan-Veprimit të Sektorit të Energjisë, përveç arkëtimeve nga ndërmarrjet e ujësjellësve. Në këtë kuadër, ne mirëpresim shlyerjen e borxheve të para vitit 2007 që kanë institucionet e sektorit publik ndaj KESH-it. Gjithësesi, kufizimet e energjisë elektrike këtë vit kanë qënë më të pakta sesa ishin parashikuar në Plan-Veprim. Nisur

nga kjo dhe nga ndikimi i pafavorshëm i thatësirës mbi prodhimin e energjisë elektrike, do të nevojiten masa të tjera të rëndësishme për të mbrojtur buxhetin e vitit 2007, sikurse janë fokusimi më i mirë i kufizimeve, rritja e çmimit të energjisë elektrike si edhe përmirësimet e mëtejshme në performancën e arkëtimeve dhe humbjeve të KESH-it. Duke shikuar përpara, kjo do të lehtësojë kalimin drejt një furnizimi të pandërprerë me energji elektrike në vitin 2008.

“Një mision rishikimi i FMN-së do të vizitohet Tiranën në 31 Tetor–13 Nëntor 2007. Nëse arrihet mirëkuptim mbi masat e duhura të politikave, pritet që rishikimi i katërt i programit aktual të kombinuar PRGF/EFF do t’i paraqitet Bordit Ekzekutiv të FMN-së në Janar të vitit 2008.

“Misioni i shpreh falenderimet e veta autoriteteve shqiptare për bashkëpunimin e tyre të ngushtë dhe të vazhdueshëm, si edhe për mikëpritjen e ngrohtë.”